

Rimbursimi i shpenzimeve që nuk përfshihen në vlerën e tatueshme

Në zbatim të Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, nuk përfshihen në vlerën e tatueshme të një furnizimi, shumat që ka marrë një person i tatueshëm nga ana e blerësit apo klientit të tij, si rimbursim për shpenzimet e bëra në emër dhe për llogari të këtyre të fundit dhe të regjistruara në kontabilitetin e personit të tatueshëm si llogari provizore.

Këto shuma të marra si rimbursim i shpenzimeve të dokumentuara për llogari të porositësve të tyre, nuk përfshihen në vlerën e tatueshme të furnizimit, kur plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Personi i tatueshëm duhet të paraqesë prova të shumës efektive të këtyre shpenzimeve, të cilat janë të një natyre specifike dhe nuk duhet të kryejë zbritje të TVSH-së, që mund të jetë llogaritur mbi këto shuma.
- b) Nëse personi i cili kryen shpenzimet, i faturon personit në emër të të cilit ka vepruar, komision/tarifë për kryerjen e këtyre pagesave, ose shton vlerë mbi shpenzimet e bëra të dokumentuara, atëherë nuk jemi në kushtet e zbatimit të nenit 40, pika 1/c të ligjit.

Kujdes!

Nëse shpenzimet futen në koston totale të shërbimit atëherë këto shpenzime përfshihen në vlerën e tatueshme të furnizimit.

Modalitetet dhe rregullat e zbatimit

Në zbatim të modaliteteve, përcaktohen palët pjesëmarrëse si më poshtë:

- a) I pari - mund të jetë person i tatueshëm ose jo;
- b) I dyti - është person i tatueshëm i kontraktuar nga i pari për kryerjen e një shërbimi, për kryerjen e të cilit nevojiten të kryhen këto shpenzime për llogari dhe në emër të personit të parë;
- c) I treti - është personi të cilit i kryhen pagesat nga i dyti, autorizuar prej personit të parë për llogari të tij.

Kushtet për mospërfshirjen e këtyre vlerave në vlerën e tatueshme të furnizimit

1- Të jetë nënshkruar një kontratë midis palëve, ku të jenë përcaktuar veprimet që do të kryejnë palët. Të tregohet se veprimet që do të kryhen janë kryer prej personit të autorizuar (i dyti) me autorizim (urdhër) dhe në emër të të parit. Për të justifikuar çdo shpenzim të kryer, duhet të jetë përpiluar një dokument ligjor ku personi i parë të këtë deleguar/autorizuar të drejtat për të vepruar në emër dhe për llogari të tij. Nëse këto shpenzime nuk janë parashikuar në kontratë, duhet të vërtetohen që janë kryer për këtë qëllim dhe për llogari të personit autorizues.

2- Duhet të ekzistojë një faturë ose dokument i qartë, ku evidentohet shuma e saktë e paguar dhe të dhënat e personit për të cilin ka qenë e detyrueshme të kryhej pagesa, e cila ka lidhje me një furnizim shërbimi, që i dyti do të kryejë për llogari të të parit. Shuma e paguar në emër dhe për llogari të klientit duhet të jetë e barabartë me shumën e arkëtuar nga klienti për këtë qëllim.

3- Këto shpenzime duhet të justifikohen me saktësi dhe qartësisht për autoritetin tatimor duke iu bashkëngjitur dokumenti justifikues, dokumentet e pagesës, si dhe një kopje e dokumentit/autorizimit për të deleguar të drejtat për të vepruar në emrin e tij.

4- Shpenzime të tilla që kryhen për llogari të një personi tjetër, në kontabilitet duhet të jenë regjistruar në llogari provizore. Është kusht që këto shpenzime të kryhen nga personi i tatueshëm për llogari të klientit të tij, përgjatë kryerjes së një shërbimi, për të cilin klienti e ka kontraktuar personin e tatueshëm.

Theksojmë se, nëse kushtet e mësipërme nuk plotësohen, atëherë konsiderohet shërbim i tatueshëm. Gjithashtu nëse shpenzime të tilla nuk provohen dhe dokumentohen sipas rregullave të përcaktuara në dispozitat ligjore, atëherë vlera e tyre e plotë ose vlera e paprovuar apo dokumentuar do të konsiderohet vlerë e tatueshme për të cilën zbatohet TVSH.